


Aksidentet Rrugore*

Janar 2026

Në muajin janar 2026 janë regjistruar 96 aksidente rrugore, në të cilat 149 persona kanë mbetur të aksidentuar (të vrarë dhe të plagosur).

Në muajin janar 2026, numri i aksidenteve rrugore është ulur me 23,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

FIG. 1 AKSIDENTET RRUGORE DHE TË AKSIDENTUARIT (TË VRARË E TË PLAGOSUR), JANAR 2022 – JANAR 2026



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Gjatë muajit Janar 2026, 85,4 % e aksidenteve rrugore kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve.

Grup-mosha 25–34 vjeç paraqet numrin më të lartë të aksidenteve, duke përbërë 31,3 % të numrit gjithsej të aksidenteve të regjistruara në këtë periudhë.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore, sipas ditëve të javës, është shënuar ditën e premte me 21,9 %, ndërsa numri më i ulët është regjistruar ditën e martë me 6,3 %.

*Të dhënat e publikuara janë paraprake dhe subjekt i përditësimit.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore është regjistruar përgjatë harkut kohor 19:00–24:00, duke përbërë 24,0 % të numrit total të aksidenteve rrugore.

TAB.1 AKSIDENTET RRUGORE, NUMRI I TË VDEKURVE DHE TË PLAGOSURVE, SIPAS QARQEVE

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Janar 2025	Janar 2026	Janar 2025	Janar 2025
Shqipëria	125	96	174	149
Berat	1	1	1	1
Dibër	2	1	7	3
Durrës	9	9	12	14
Elbasan	5	6	6	9
Fier	12	3	16	4
Gjirokastrë	6	4	14	8
Korçë	13	5	16	5
Kukës	4	5	4	7
Lezhë	15	16	23	41
Shkodër	9	2	11	4
Tiranë	40	38	50	44
Vlorë	9	6	14	9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT-it, në seksionin: [Transporti, Aksidentet dhe Karakteristikat e Mjetet Rrugore](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Transporti, Aksidentet dhe Karakteristikat e Mjetet Rrugore](#)

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e treguesve mbi aksidentet rrugore, si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrin e personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore, të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend, duke i krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni që i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme, ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla, që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private, në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, dhe që rezulton në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person që ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, duke përjashtuar rastet e vetëvrasjeve.

I plagosur: Çdo person që, si rezultat i një aksidenti, nuk është vrarë menjëherë ose nuk ka vdekur brenda 30 ditëve, por ka pësuar një dëmtim për të cilin ka lindur nevoja për trajtim mjekësor, duke përjashtuar rastet e vetëvrasjeve në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor", si: frenim i papritur, mosrespektim i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektim i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor", si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Brendshme / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë informacion, referojuni te Politika e Revizionimit Statistikor: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 – Vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- Pa vlerë
- (...) – Mungesë të dhënash